

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Burim Shala e Lumni Sallauka – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit S.P. nga Prishtina, kundër të paditurës Koorporata Energjetike e Kosovës (KEK) me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari Z.SH., jurist pranë të paditurës, për shkak të kompensimit të të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.654/12, të datës 13.10.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 12.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Koorporata Energjetike e Kosovës (KEK) me seli në Prishtinë.

II. NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.654/12, i datës 13.10.2014 dhe çështja lëndore gjykohet si në vijim: **REFUZHET SI E PABAZUAR** kërkesëpadia e paditësit S.P. nga Prishtina, përmes të cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura Koorporata Energjetike e Kosovës (KEK) me seli në Prishtinë, që në emër të ndihmës ekonomike me rastin e lëndimit në punë, t'ia kompensoj paditësit dy paga në shumën prej 692 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.654/12, të datës 13.10.2014, e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit S.P. nga Prishtina dhe e ka detyruar të paditurën Koorporata Energjetike e Kosovës (KEK) me selin në Prishtinë, që paditësit t'ia paguajë dy paga në emër të ndihmës ekonomike me rastin e lëndimit në punë që përfshinë shumën e përgjithshme prej 692.00 euro, me kamatë vonesë vjetore prej 3.5%, nga data 16.09.2014, e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 30 euro, e të gjitha këto në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë e paditura për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që të refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi S.P. nga Prishtina, në gjykatën e shkallës së parë me datë 26.03.2012, ka paraqitur padi për kompensimin e dy pagave mujore, me arsye sikurse në padi.

Gjykata duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresat tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.654/12, të datës 13.10.2014, me të cilën e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar gjykata ka theksuar se me datë 07.09.2011, ka ndodhur aksidenti në punë ku paditësi ka pësuar lëndime trupore, rrethanë të cilën e ka vërtetuar nga raporti për ndërprerjen e përkohshme për punë, i lëshuar nga Instituti i Mjekësisë së Punës, ku prej datës 07.09.2011, deri më datë 11.12.2011, paditësi ka qenë në pushim mjekësor. Tutje ceket se paditësi me datën 07.03.2012, i është drejtuar të paditurës për ndihmë ekonomike me rastin e lëndimit në punë dhe meqenëse e njëjta nuk ka marrë përgjigje nga e paditura, me datë 26.03.2012, ka paraqitur padi për realizimin e kërkesës së tij. Se paditësi ka realizuar pagë mujore për çdo muaj, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në bazë të listës së pagave për vitin 2011-2012.

Me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar, gjykata ka arsyetuar se e njëjta është e bazuar për faktin se në bazë të Marrëveshjes Kolektive të lidhur në mes të KEK-ut dhe SPEK-ut, të datës 20.12.2002, respektivisht nenit 33 të saj përcaktohet se *“në rast të vdekjes së punëmarrësit ose pjesëtarëve të familjes (bashkëshorti, fëmija) së tij, që bashkëtojnë, si dhe në rastet e sëmundjes së gjatë të punëmarrësit, me propozim të përfaqësuesit të punëtorit jepet një ndihmë ekonomike në lartësi të dy pagave mujore”*, andaj gjykata duke u gjendur pranë një shtate të tillë, ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit. Pretendimet e të paditurës se kjo e drejtë nuk i takon paditësit sepse me hyrjen në fuqi të Kodit të Punës, janë zëvendësuar të gjitha kushtet dhe afatet e paraqitura me Marrëveshjen Kolektive të KEK-ut, të datës 12.12.2012, dhe se me Kodin e Punës nuk është paraparë një kompensim i tillë siç pretendon paditësi, gjykata e shkallës

së parë i ka vlerësuar si të pabazuara, pasi që Kodi i Punës është aprovuar me vendim nr.110829-5/1, të Bordit të Drejtorëve të KEK-ut, ndërsa është implementuar nga data 29.09.2011, në bazë të Urdhëresës Ekzekutive, ndërsa lëndimi në punë ka ndodhur me datë 07.09.2011, që do të thotë para se të implementohet Kodi i Punës. Lidhur me kamatën ka vendosur konform nenit 277 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Përkundër faktit se aktgjykimi i atakuar rezulton të mos jetë i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as me shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese, sipas kësaj gjykate gjendja faktike e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, nuk korrespondon drejtë me provat nga shkresat lëndore. Për pasojë me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të atakuar, ka pasur zbatim të gabuar të së drejtës materiale, pasi që gjykata ankimore me anë të vlerësimit ndryshe të shkresave dhe provave të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor nga gjykata e shkallës së parë, konstaton një gjendje tjetër faktike, nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është tërësisht e pabazuar, për çka në këtë rast ka kushte që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe të vendoset sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, Gjykata e Apelit gjeti se në rastin konkret nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se me datën 07.09.2011, i njëjti gjatë orarit të punës dhe përderisa ishte duke i kryer detyrat e punës, ka pësuar lëndim, si rezultat i të cilit kishte qenë në pushim mjekësor nga data 07.09.2011, e deri më datën 11.12.2011, me qëllim të rehabilitimit fizik dhe psiqik. Nuk është kontestues as fakti se përgjatë kësaj periudhe, paditësi ka marrë pagat e plota nga këtu e paditura. Kontestuese paraqitet kërkesa e paditësit përmes të cilës kërkon nga e paditura që përgjatë kohës sa ka qenë ky në pushim mjekësor, përveq pagave të rregullta, t'i paguhen edhe dy paga të tjera shtesë si pasojë e lëndimit të pësuar në vendin e punës, e kjo konform nenit 33 të Marrveshjes Kolektive të aprovuar në mes të Korportatës Energjetike të Kosovës (KEK) dhe Sindikatës së Pavarur të Korporatës Energjetike të Kosovës (SPEK) e cila ka hy në fuqi me 12.12.2002. Paditësi kishte parashtruar edhe kërkesë me shkrim ndaj të paditurës me qëllim të realizimit të së drejtës së tij të pretenduar në vlerën prej dy pagave mujore, por nga e paditura nuk kishte marrë përgjigje, për çka pastaj edhe e ka inicuar këtë procedurë kontestimore.

Nga shqyrtimi i provave shkresore dhe të cekurave si më lartë, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa bazuar për arsye se në rastin konkret askund me dispozita ligjore apo me akte normative të të paditurës nuk është e paraparë e drejta që në rast të lëndimit të punëtorëve të punësuar tek e paditura, përderisa

ata marrin pagën e rregullt edhe pse gjenden në pushim mjekësor brenda afatit të caktuar, t'iu paguhen edhe dy paga të tjera shtesë, si pasojë e lëndimit të pësuar në punë, i cili lëndim nuk ka shkaktuar mungesë në punë për një periudhë prej së paku 5 muaj e më tepër. Në fakt, me dispozitat e nenit 33 të Marrëveshjes Kolektive të aprovuar në mes të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) dhe Sindikatës së Pavarur të Korporatës Energjetike të Kosovës (SPEK), parashihet se *“në rast të vdekjes së punëmarrësit, ose të pjesarëve të familjes (bashkëshorti, fëmija) së tij që bashkëjetojnë, si dhe në rast të sëmundjes së gjatë të pjesmarrësit, me propozim të përfaqësuesit të punëtorit, jepet një ndihmë ekonomike në lartësi të 2 pagave mujore”*. Në rastin konkret, nuk është kontestuese se paditësi është lënduar në punë, për shkak të të cilit lëndim ai kishte munguar në punë nga data 07.09.2011 e deri me datën 11.12.2011, por sipas interpretimit të Gjykatës së Apelit, lëndimi i tillë nuk konsiderohet **sëmundje e gjatë e punëmarrësit** sikurse kërkohet të jetë rasti me nenin 33 të Marrëveshjes Kolektive të cituar si më lartë, sepse paditësi në këtë rast si pasojë e lëndimit ka munguar në punë rreth 3 muaj, në ndërkohë që brenda kësaj periudhe i njëjti ka realizuar pagën e plotë nga këtu e paditura. Po ashtu sipas Marrëveshjes Kolektive të cekur si më lartë, kërkesa për një ndihmë të tillë duhet të bëhet përmes propozimit të përfaqësuesit të punëtorit, e që në rastin konkret e njëjta nuk është parashtruar sipas këtij rregulli, sepse askund në shkresat e lëndës nuk provohet se në procedurë gjyqësore apo edhe në rastin e parashtrimit të kërkesës nga paditësi, të jetë përfshirë edhe përfaqësuesi i punëtorëve, apo siq lë të nënkuptohet se duhet të jetë përfaqësuesi i sindikatës së tyre.

Gjykata e Apelit vlerëson se baza ligjore për vendosje qendron në Marrëveshjen Kolektive të cituar si më lartë, edhe pse e njëjta është nënshkruar më 08.10.2001, pa u cekur afati kohor i kohëzgjatjes së saj, sepse edhe me Kodin e Punës nr.1 të të paditurës, të aprovuar me vendimin nr.110829-5/1, të Bordit të Drejtorëve të KEK-ut, me 29.08.2011 dhe implementuar në bazë të Urdhërësës Ekzekutive të datës 29.09.2011, në pjesën e parathënies së saj, pika 4, decidivisht ceket se *“Ky Kod i Punës hynë në fuqi nga data e theksuar në Urdhërësën Ekzekutive implementuese (pra 29.09.2011), të nënshkruar nga Drejtori Menaxhues dhe nuk do të ketë fuqi prapavepruese, me përjashtim nëse theksohet shprehimisht ndryshe”*, ndërsa me pikën 7 të pjesës së parathënies së saj parashihet se *“për më tej dhe për të hequr dyshimin ky Kod i Punës i zëvendëson të gjitha kushtet dhe afatet e paraqitura në Marrëveshjen Kolektive të KEK-ut të datës 12.12.2002”*, që sipas vlerësimit të kësaj gjykate, për rastin në fjalë vlejné dispozitat e Marrëveshjes Kolektive të nënshkruar nga KEK dhe SPEK, të datës 12.12.2002. Në anën tjetër me Kodin në fjalë të punës, si akt normativ pasues i Marrëveshjes Kolektive të cekur më lartë, askund nuk parashihet një formë e kompensimit të tillë të punëmarrësit nga ana e punëdhënësit në këtë rast këtu të paditurës.

Në këtë rast dhe për arsye të cekura si më lartë, Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka konstatuar dhe ka vendosur që kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për faktin se në rastin konkret neni 33 i Marrëveshjes Kolektive,

nuk mund të gjejë zbatim dhe të interpretohet sikurse është intepretuar në rastin konkret nga ana e gjykatës së shkallës së parë, ngase lëndimi i të njëjtit nuk është kualifikuar si i tillë dhe me kohëzgjatje mbi 5 muaj, por edhe sepse propozimi për një ndihmë të tillë nuk është parashtruar në formën siç kërkohet me aktet normative të të paditurës të cekura si më lartë, në ndërkohë që është provuar se ai përgjatë periudhës 3 mujore, aq sa ka munguar në punë si pasojë e lëndimit të tij, ka realizuar pagë të plotë mujore nga e paditura.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykata e shkallës së parë, gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale, sepse askund në aktet normative të të paditurës nuk është e paraparë mundësia që për shkak të lëndimit të llojit sikurse të paditësit në rastin konkret, përderisa i njëjti realizon paga të plota nga e paditura, nga kjo e fundit të rëndoje detyrimi për pagesën edhe të dy pagave shtesë, aq më tepër që edhe kërkesa nuk është parashtruar konform rregullave të parapra me aktet normative të të paditurës.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera nga padia, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 452.2 të LPK-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale, pasi që e paditura nuk i kishte kërkuar ato.

Andaj, nga të lartcekurat, e në mbështetje të nenit 195 paragraf. 1 pika e), e lidhur me nenin 201 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.177/15, me datën 12.10.2018

**Kryetari i kolegjit – Gjyqtari
Valon Totaj**